

Strategjia e Hetimit dhe Parandalimit të Kriminalitetit Zgjedhor

SPAK 

STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Zgjedhjet për Kuvendin
2025

Strategjia e Hetimit dhe Parandalimit të Krimit Zgjedhor

Zgjedhjet për Kuvendin 2025

Pasqyra e lëndës

Hyrje	3
Misioni	4
Qëllimi	5
Objektivat	5
Qasja	5
Korniza Ligjore	7
Analiza e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve nga SPAK (2021-2024)	8
Sfidat e Parashikuara	10
Plani i Masave	12
Faza përgatitore (janar-shkurt 2025)	12
Faza e Vëzhgimit (mars-maj 2025).....	12
Infrastruktura hetimore	13
Struktura Qendrore.....	13
Grupet hetimore në terren	13
Komunikimi me Publikun	14
Regjistrimi i të dhënave.....	14
Mbështetja financiare dhe infrastrukturore	14
Monitorimi dhe Vlerësimi	14
Bashkëpunimi vendas dhe ndërkombëtar	15

Hyrje

Garantimi i legjitimitetit të zgjedhjeve është faktor themelor në ruajtjen e shtetit të së drejtës dhe integritetit të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë aspekt, parandalimi dhe hetimi i veprave penale që kryhen gjatë proceseve zgjedhore është parashikuar nga ligjvënësi në ligjin material penal dhe procedural¹, ku një rëndësi të veçantë merr edhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).²

Organizatave vendase dhe ndërkombëtare, përfshirë OSBE/ODIHR, Komisioni Evropian dhe Misioni Amerikan pranë OSBE-së, kanë shprehur shqetësime të vazhdueshme lidhur me veprat penale në kuadër të zgjedhjeve në Shqipëri³. Konkluzionet e raporteve ndërkombëtare mbi zgjedhjet e zhvilluara në periudhën 2021-2023 evidentojnë ndërproblematikat kryesore: blerjen e votave⁴, keqpërdorimin e burimeve publike dhe presion ndaj votuesve, veçanërisht ndaj punonjësve të administratës shtetërore⁵; cënimin e sekretit të votës dhe paanshmërinë e medias⁶. Raportet ndërkombëtare kanë theksuar nevojën për hetime të plota, në kohë të arsyeshme dhe transparente si dhe marrjen e masave ndaj shkelësve të ligjit, duke sugjeruar mbikëqyrje më të thelluar mbi përdorimin e burimeve publike dhe ofrimin e mbrojtjes me cilësore të denoncuesve të krimin zgjedhor⁷. Komisioni Evropian ka nënvizuar nevojën për fuqizimin e institucioneve të drejtësisë për të adresuar kulturën e pandëshkueshmërisë⁸, ku përfshihen dhe rastet e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve.

¹ Shih seksionin “Korniza Ligjore” të kësaj Strategjie.

² Termi “Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar” përdoret për t’u referuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Njësisë së Posaçme Hetimore, e cila emërtohet “Byroja Kombëtare e Hetimit”. Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar quhet shkurtimisht “SPAK”. Shih Ligjin nr.95/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar, neni 3, paragrafi 7.

³ Instituti i Studimeve Politike (2024). *SPAK dhe zgjedhjet në Shqipëri*. Marrë nga [ISP-raport-SPAK-dhe-zgjedhjet-ne-Shqiperi.pdf](#). Misioni i Shteteve të Bashkuara në OSBE. (2021). *Deklaratë për Zgjedhjet Parlamentare në Shqipëri, e paraqitur nga Zv/drejtori i Përkohshëm i Misionit, Elisabeth Rosenstock-Siller, në Këshillin e Përhershëm, Vjenë, 6 maj 2021*. Marrë nga <https://osce.usmission.gov/statement-on-albanian-parliamentary-elections/>.

⁴ OSCE/ODIHR (2023). *Zgjedhjet vendore 14 maj 2023: Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve*. Marrë nga <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>, faqe 1.

⁵ Komisioni Evropian (2023). *Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2023. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Zgjerimit të BE-së*. Marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, faqe 8.

⁶ Komisioni Evropian (2024). *Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Zgjerimit të BE-së*. Marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania_Report_2024.pdf, faqe 22.

⁷ OSCE/ODIHR (2021). *Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021: Misioni i Kufizuar i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar*. Marrë nga <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>, faqe 16.

⁸ Komisioni Evropian (2023). *Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2023. Shoqëruar me dokumentin Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social të Evropës dhe Komitetin e Rajoneve*. Marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf, faqe 4.

Ndërkohë, edhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka konsideruar hetimin e krimit zgjedhor si një çështje të rëndësishme për tu trajtuar, duke e përfshirë atë në një ndër rekomandimet për tu konsideruar veçanërisht nga SPAK në “Rezolutën për Vlerësimin e Veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për Vitin 2023”⁹.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe rekomandimit të Kuvendit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) parashikon një qasje strategjike për të parandaluar dhe hetuar veprat penale nën juridiksionin e saj gjatë zgjedhjeve për Kuvendin 2025, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Kjo Strategji bazohet në gjetjet e raporteve të organizatave vendase dhe ndërkombëtare të sipërpërmendura si dhe në analizën e brendshme të Prokurorisë së Posaçme mbi procedimet penale të regjistruara në 4 (katër) vitet fundit¹⁰.

Ajo udhëhiqet nga qasja proaktive e hetimit dhe provueshmëria në kohë reale e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve, duke synuar efekte konkrete për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe pacenueshmërinë e të drejtës së qytetarëve për të votuar në zgjedhjet për Kuvendin 2025.

Nga ana tjetër, kjo Strategji synon të parandalojë ndikimin e krimit të organizuar në integritetin e procesit zgjedhor, përmes masave konkrete dhe përdorimit sa më efektiv të teknikave të posaçme hetimore.

Strategjia ka gjithashtu si qëllim të forcojë besimin e publikut tek agjencitë e zbatimit të ligjit, duke parandaluar në kohë pasojat e mundshme të përshkallëzimit të veprave penale në kuadër të zgjedhjeve. Ajo shërben si udhërrëfyes për prokurorët e posaçëm, hetuesit dhe stafin administrativ mbështetës të SPAK dhe synon të jetë gjithashtu një dokument lehtësisht i kuptueshëm për publikun.

Misioni

Misioni i SPAK nëpërmjet kësaj Strategjie është garantimi i të drejtës kushtetuese të qytetarëve për të votuar në një proces të lirë dhe të ndershëm zgjedhor, nëpërmjet sigurimit të integritetit dhe paanshmërisë së ndjekjes penale, në kuadër të hetimit të veprave penale gjatë procesit zgjedhor.

⁹ Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024” Rekomandimi nr. 5. Në këtë rekomandim parashikohet që: “T’u kushtohet vëmendje krimeve zgjedhore, veçanërisht fakteve të bëra publike në media para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, për të filluar hetimin kryesisht në rastet kur ka njoftime publike për kryerjen e një vepre penale”.

¹⁰ Shiko seksionin “Analiza e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve nga SPAK (2021-2024), në këtë Strategji.

Qëllimi

Qëllimi i SPAK nëpërmjet kësaj Strategjie është parandalimi dhe hetimi i veprave penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025, përmes kryerjes së hetimit të veprave penale në mënyrë të plotë, në kohë të arsyeshme dhe me transparencë, në funksion kjo edhe të parandalimit të kryerjes së këtyre veprave penale.

Objektivat

Objektivat për përmbushjen e synimit të kësaj Strategjie janë:

1. Identifikimi sa më i shpejtë i indicieeve mbi mundësitë e kryerjes së veprave penale dhe shkeljeve ligjore në kuadër të zgjedhjeve që mund të ndikojnë në integritetin e procesit zgjedhor.
2. Identifikimi dhe parandalimi i ndikimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit të funksionarëve shtetërorë dhe subjekteve private në procesin zgjedhor për të siguruar një proces të lirë dhe të ndershëm zgjedhor për Kuvendin 2025.
3. Përmirësimi i kapaciteteve hetimore të Prokurorisë së Posaçme për të hetuar dhe ndjekur rastet e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve në mënyrë efektive.
4. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut mbi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet hetimore dhe rolin e tyre ndërveprues në parandalimin e krimit zgjedhor.
5. Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet publike, shoqërinë civile, median dhe çdo subjekt privat për të parandaluar veprat penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025.
6. Parandalimi i ndikimit të jashtëm dhe manipulimit të procesit zgjedhor përmes monitorimit në kohë reale dhe ndërhyrjes së shpejtë në rastet e dyshimta të shkeljes së ligjit.
7. Kryerja e hetimeve profesionale dhe të shpejta për subjektet që kryejnë shkelje zgjedhore, duke dërguar një mesazh të qartë se krimi zgjedhor do të ndiqet dhe ndëshkohet.

Qasja

Strategjia hetimore do të mbështetet mbi:

Pavarësinë institucionale

- Kuadri ligjor garanton që hetimet për veprat penale në kuadër të zgjedhjeve të kryhen pa ndërhyrje politike apo presione të jashtme, duke respektuar pavarësinë e SPAK.

Monitorimin dhe hetimin dinamik

- Përfshirja e grupeve hetimore në terren për të monitoruar në kohë reale situatat për të cilat mund të ketë indicie për kryerjen e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025.
- Identifikimi jo vetëm i subjekteve të posaçme apo individëve të përfshirë në korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje, por dhe i grupeve të strukturuar kriminale të cilat dyshohen se ndikojnë në zgjedhje.
- Monitorimi i përdorimit të buxhetit, investimeve dhe infrastrukturës publike, të cilat nuk lejohen të kryhen gjatë periudhës zgjedhore nga subjektet e posaçme.

Parandalimin e krimit zgjedhor

- Strategjia i vendos theks të veçantë masave parandaluese¹¹, për të siguruar një bashkëpunim në kohë reale me publikun, gazetarët/median dhe shoqërinë civile në lidhje me sensibilizimin por dhe denoncimin e rasteve të dyshuara.
- Identifikimi i zonave ku janë shfaqur më parë raste të veprave penale në kuadër të zgjedhjeve dhe përqendrimi i burimeve hetimore në to.

Efektivitetin në hetime

- Përdorimi i teknikave të posaçme të hetimit, përfshirë hetimet financiare dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për të siguruar një hetim të shpejtë dhe efektiv të rasteve.

Transparencën dhe llogaridhënien

- Komunikim në kohë reale me publikun dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) mbi veprat penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025 në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme.
- Ngritja e një platforme të dedikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme për denoncimin e rasteve.

Bashkëpunimin ndërinstitucional

- Prokuroria e Posaçme do të bashkëpunojë ngushtë me Prokurorinë e Përgjithshme, zyrat e prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, KQZ, Policinë e Shtetit, agjenci të tjera ligjzbatuese, organizmat ndërkombëtar, organizata të shoqërisë civile për të rritur efektivitetin e hetimeve për veprat penale në kuadër të zgjedhjeve.

¹¹ Shih seksionin “Plani i Masave“ të kësaj Strategjie.

Korniza Ligjore

Korniza ligjore për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në kuadër të zgjedhjeve në Shqipëri, përcakton juridiksionin e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme dhe institucioneve të tjera përkatëse me qëllim mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë***, neni 135, paragrafi 2, dhe neni 148, paragrafi 3, përcaktojnë pavarësinë dhe funksionin kushtetues të Prokurorisë së Posaçme në hetimin e çdo veprave penale që kryhet nga subjektet e posaçme.
- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “***Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë***”, i ndryshuar parashikon dy vepra penale të cilat hetohen nga Prokuroria e Posaçme si:
 - *Korrupsioni aktiv gjatë zgjedhjeve* (Neni 328 i Kodit Penal), i cili përfshin veprime të cilat konsiderohen si korrupsion për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.
 - *Korrupsioni pasiv gjatë zgjedhjeve* (Neni 328/b i Kodit Penal), i cili përfshin pranimin e përfitimeve për të ndikuar te votuesit ose kandidatët.
- Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 “***Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë***”, i ndryshuar, neni 75/a geramat (b), (c), dhe (ç), parashikon juridiksionin lëndor të Prokurorisë së Posaçme ku përfshihen veprat penale në kuadër të zgjedhjeve dhe subjektet e posaçme.
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “***Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë***”, i ndryshuar, neni 91, parashikon ndalimin e përdorimit të administratës apo edhe infrastrukturës publike në funksion të fushatës zgjedhore nga subjektet e posaçme.
- **Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”**, i ndryshuar, neni 8 dhe neni 10 parashikon kompetencat lëndore dhe juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme që shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- **Ligji nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar neni 42 gërma (e) dhe neni 107/1, lidhen me hetimin e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve dhe bashkëpunimin me KQZ, në dhënien e informacionit kësaj të fundit për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cënon ruajtjen e sekretit hetimor.

Analiza e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve nga SPAK (2021-2024)

Për periudhën 2021-2024, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar gjithsej 110 procedime penale në kuadër të krimeve zgjedhore (Tabela). Analiza ka renditur sipas numrit më të lartë të çështjeve, problematikat e evidentuara në tabelën më poshtë:

Tabela

Të dhëna statistikore për çështjet e regjistruara për veprat penale në kuadër të zgjedhjeve
2021-2024

Viti	Regjistruar	Kërkesë për gjykim	Kërkesë për pushim	Transferuar	Pezulluar	Bashkuar	Mbeten në hetim
	Çështje	Çështje	Çështje	Çështje	Çështje	Çështje	
2021	62	2	8	22	1	4	
2022	5	3	4	3	3		
2023	36	8	6	2	1		
2024	7	1	13	5	2		
Total ¹²	110	14	31	32	7	4	22

1. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit mbi ndarjen e kompetencave mes Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm (29.1% e çështjeve)

- 32 raste janë transferuar në zyrat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, duke sugjeruar se një përqindje e konsiderueshme e çështjeve të regjistruara fillimisht nga Prokuroria e Posaçme nuk ishin brenda juridiksionit të saj.
- Ky tregues sinjalizoi nevojën për identifikim dhe dokumentim të rasteve gjatë fazës së parë të hetimeve, për të shmangur vonesat e panevojshme që vijnë nga referimi i papërcaktuar qartë i rasteve nga denoncuesit/kallëzuesit.

2. Mungesa e provave të mjaftueshme për një pjesë të konsiderueshme të rasteve (28.2% e çështjeve)

- 31 çështje janë pushuar, kryesisht për shkak të mungesës së provave ose pamundësisë për të identifikuar shkelësit e ligjit.

¹² Nga 110 procedime penale në kuadër të veprave penale që lidhen me zgjedhjet, 4 prej tyre janë bashkuar.

- Ky është tregues se në disa raste, hetimet janë vështirësuar nga mungesa e bashkëpunimit të dëshmitarëve si dhe vështirësia në sigurimin e materialeve provuese.

3. Nevoja për rritjen e kapaciteteve hetimore për çështjet në vijim (20% e çështjeve)

- **22 raste janë ende në hetim**, shifër që tregon se Prokuroria e Posaçme është ende duke punuar në një numër të konsiderueshëm çështjesh.
- Ky tregues nxjerr në pah nevojën për ngritjen e kapaciteteve të vazhdueshme njerëzore për të përshpejtuar dhe finalizuar hetimet, duke maksimizuar efektivitetin e ndjekjes penale në kuadër të veprave penale që lidhen me zgjedhjet.

4. Nevoja për rritjen e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim (12.7% e çështjeve)

- **Vetëm 14 çështje janë dërguar për gjykim**, duke sugjeruar se përqindja e hetimeve që përfundojnë me ngritjen e akuzave dhe dërgimin e tyre në gjykatë nuk është brenda pritshmërisë së Prokurorisë së Posaçme.
- Ky tregues lidhet me vështirësitë e hasura në mbledhjen e provave, mungesën e bashkëpunimit nga dëshmitarët, kompleksitetin e veprave penale dhe subjekteve që hetohen nga Prokuroria e Posaçme.

5. Koha e zgjatur e hetimeve dhe pezullimi i çështjeve (6.4% e çështjeve)

- **7 raste janë pezulluar**, duke treguar se në disa raste, hetimi ka hasur në vështirësi kryesisht për shkak të mungesës së provave thelbësore ose për shkak të identifikimit të autorit të veprës penale.
- Kjo problematikë nënvizon rëndësinë e sigurimit të burimeve të mjaftueshme hetimore dhe përmirësimit të bashkëpunimit me institucionet që mund të ndihmojnë në sigurimin e provave me qëllim rritjen e efektivitetin dhe dërgimin e çështjeve për gjykim.

Mbështetur në të dhënat e paraqitura më sipër, analizën e thelluar dhe përvojën e fituar në hetimin e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve gjatë periudhës 2021-2024 në SPAK, u vlerësua e nevojshme konceptimi i kësaj Strategjie. Ajo adreson sfidat kryesore që lidhen me forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, përmirësimin e mekanizmave të mbledhjes së provave dhe rritjen e efektivitetit të hetimit.

Sfidat e Parashikuara

Burimet e kufizuara njerëzore dhe logjistike

- Një nga sfidat kryesore në zbatimin e kësaj Strategjisë është numri i kufizuar i burimeve njerëzore. Me vetëm 20 prokurorë, 60 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe 12 hetues financiarë, SPAK do të duhet të mbulojë të gjithë territorin e Shqipërisë, duke garantuar një ndjekje efektive të të gjitha rasteve të dyshuara. Ky kapacitet i kufizuar mund të ndikojë në kohëzgjatjen e hetimeve dhe në aftësinë për të ndjekur të gjitha rastet me intensitetin dhe përqendrimin e duhur. Për të minimizuar këtë sfidë, do të nevojitet një shpërndarje më efektive e burimeve, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.

Vështirësitë në hetimin e veprave penale të lidhura me votimin e diasporës

- Votimi i shqiptarëve të diasporës përbën një sfidë të re dhe të ndërlikuar për hetimin e mundshëm të shkeljeve zgjedhore. Identifikimi i autorëve të manipulimeve të mundshme apo blerjes së votave në një kontekst ndërkombëtar do të kërkojë bashkëpunim më intensiv me autoritetet ligjzbatuese të vendeve të tjera. Kjo mund të shtojë kompleksitetin procedural dhe të vonojë hetimet, për shkak të vështirësive në shkëmbimin e informacionit dhe ekzekutimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjelltë juridike.

Rritja e ngarkesës gjatë periudhës zgjedhore

- Gjatë fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit, rritja e mundshme e denoncimeve dhe nevoja për hetime të menjëhershme do të shtojë ngarkesën mbi SPAK dhe institucionet e tjera përgjegjëse. Hetimet proaktive, të cilat kërkojnë verifikim të tw dhwnave ose denoncimeve nw kohw të shpejtë, mund të vënë në vështirësi kapacitetet e disponueshme që SPAK do duhet të sigurojë. Kjo sfidë do të kërkojë një koordinim të ngushtë dhe bashkëpunim konstruktive të institucioneve të tjera publike.

Presionet politike dhe ndikimet e jashtme

- Hetimi i veprave penale në kuadër të zgjedhjeve shpesh mund të jetë subjekt i presioneve politike dhe ndërhyrjeve të ndryshme të jashtëligjshme, të cilat mund të synojnë devijimin ose vonesën e hetimeve. Këto ndërhyrje mund të ndikojnë tek dëshmitarët, tek të hetuarit apo edhe tek institucionet përgjegjëse për hetimin dhe gjykimin e rasteve. Garantimi i pavarësisë së SPAK nga të gjithë aktorët dhe sigurimi i mbështetjes institucionale do të jenë thelbësorë për të përballuar këtë sfidë.

Keqinformimi i opinionit publik

- Një tjetër pengesë e mundshme është rreziku i keqinformimit të opinionit publik me lajme të pavërteta mbi hetimet e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve. Përcjellja e informacioneve të pasakta në media apo në platformat sociale mund të minojë besimin tek institucionet përgjegjëse dhe të krijojë perceptime të gabuara mbi ecurinë dhe objektivitetin e hetimeve. Për të luftuar këtë fenomen, SPAK duhet të përmirësojë komunikimin institucional dhe transparencën, duke garantuar informim të saktë dhe në kohë mbi hetimet dhe rezultatet e tyre.

Rritja e denoncimeve të rreme dhe mungesa e bashkëpunimit të dëshmitarëve

- Një sfidë tjetër e rëndësishme është rritja e denoncimeve të rreme, të cilat mund të devijojnë fokusin nga rastet reale. SPAK do të duhet të zbatojë mekanizma më efektivë për filtrimin dhe verifikimin e denoncimeve, duke shmangur shpërdorimin e burimeve për hetime të pabazuara. Në të njëjtën kohë, mosbashkëpunimi i dëshmitarëve për shkak të frikës, presioneve apo mungesës së besimit tek institucionet përgjegjëse, mund të pengojë marrjen e provave të nevojshme për ndjekjen penale të rasteve. Për të adresuar këtë sfidë, do të jetë i nevojshëm forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së dëshmitarëve, në përputhje me garantitë kushtetuese dhe ligjore si dhe sigurimi i kushteve për një bashkëpunim më efektiv ndërinstitutional.

Hetimi i financimit të paligjshëm të veprave penale në kuadër të zgjedhjeve

- Duke pasur parasysh nivelin relativisht të konsiderueshëm të informalitetit në ekonomi¹³, një nga aspektet më problematike në hetimin e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve është gjurmimi dhe verifikimi i fondeve të përdorura për blerjen e votave. Përdorimi i parasë *cash*, i cili është i vështirë për t'u ndjekur, si dhe mungesa e bashkëpunimit nga individë apo subjekte private të përfshira, përbëjnë sfida të mëdha për organet hetimore. Në këtë kuadër, do të jetë e domosdoshme rritja e bashkëpunimit me institucionet financiare, forcimi i mekanizmave të raportimit të transaksioneve të dyshimta dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për ndjekjen e fondeve që vijnë nga jashtë Shqipërisë.

Ndikimi i krimit të organizuar në procesin zgjedhor

- Një tjetër sfidë madhore është ndikimi i krimit të organizuar në zgjedhje, i cili shpesh manifestohet përmes blerjes së votave, presioneve ndaj votuesve dhe financimit të paligjshëm të kandidatëve të caktuar. Grupet kriminale, për interesat e tyre të paligjshme shpesh ndërhyjnë në procesin zgjedhor përmes kërcënimeve,

¹³ Komisioni Evropian (2024). Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Zgjerimit të BE-së. Marrë nga [enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania Report 2024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf), faqe 76.

manipulimeve financiare, korrupsionit të zyrtarëve zgjedhorë, etj. Përballja me këtë fenomen kërkon një reagim të koordinuar mes SPAK, Policisë së Shtetit, agjencive të tjera ligjzbatuese dhe partnerëve ndërkombëtarë për të identifikuar dhe neutralizuar çdo përpjekje të grupeve kriminale për të ndikuar në zgjedhje.

Plani i Masave

Ngritja e një Grupi Hetimor (Task-Force), i cili përbëhet nga një Strukturë Qendrore dhe grupet hetimore të dedikuara në terren, që do të kryejnë veprime hetimore gjatë periudhës zgjedhore deri në nxjerrjen e rezultateve nga KQZ.

Faza përgatitore (janar-shkurt 2025)

- Miratimi i Strategjisë.
- Lëshimi i Urdhrit për zbatim të kësaj Strategjie.
- Komunikimi me publikun rreth Strategjisë dhe planit të punës.
- Ngritja e Grupit Hetimor (Task-Force), e përbërë nga një Strukturë Qendrore dhe grupet hetimore lëvizëse në terren.
- Nënshkrimi, nëse është e nevojshme, i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit, KQZ, Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF), Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH) dhe institucione të tjera gjatë periudhës zgjedhore.
- Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore, përmes organizimit të trajnimeve të dedikuara për veprat penale në kuadër të zgjedhjeve me prokurorët, hetuesit e BKH-së, hetuesit financiarë dhe stafin mbështetës.
- Krijimi i platformës online për raportime anonime dhe në kohë reale.
- Formimi i grupeve hetimore në terren.
- Formimi i një grupi pune për ndjekjen/monitorimin sistematik me staf të dedikuar të raportimeve nga qytetarët, shoqëria civile, mediat si dhe komunikimin me publikun.

Faza e Vëzhgimit (mars-maj 2025)

- Verifikimi në terren i indiceve apo fakteve rreth kryerjes së veprave penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025, nën juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme.
- Verifikim i raportimeve që ngrenë dyshime të arsyeshme mbi keqpërdorimin e buxhetit dhe investimeve publike, gjatë periudhës zgjedhore prej subjekteve të posaçme.
- Monitorimi i mediave dhe rrjeteve sociale për indiciet e mundshme për kryerjen e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve.
- Intensifikimi i bashkëpunimit të ngushtë me agjencitë ligjzbatuese, AIF, sektorin bankar dhe atë financiar.

Infrastruktura hetimore

Struktura Qendrore

- Koordinon punën në nivel qendror të të gjithë grupeve hetimore në terren dhe stafit mbështetës të angazhuar në hetimin e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin 2025, gjatë periudhës zgjedhore.
- Bashkëpunon më institucionet e tjera publike, përfshirë organet e zbatimit të ligjit, organizatat ndërkombëtare, dhe organizatat e shoqërisë civile, për të siguruar një qasje të unifikuar në monitorimin e kryerjes së veprave penale që çënojnë integritetin zgjedhor.
- Koordinon dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe burimeve sipas ndarjes së grupeve hetimore në terren.
- Ndhmon në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore për monitorimin e indiceve ose vepra penale në kuadër zgjedhjeve.

Grupet hetimore në terren

- Përbëhen nga prokurorë të posaçëm, hetues të BKH-së, hetues financiarë, staf administrativ mbështetës të ndarë sipas 12 Qarqeve dhe 61 Bashkive. Secili grup drejtohet nga një prokuror i posaçëm.
- Gjatë periudhës zgjedhore dhe ditës së votimit grupet hetimore në terren do të fokusohen në verifikimin e denoncimeve lidhur me raportimet e aktiviteteve të kryera nga subjekte të posaçme si dhe mundësinë e përdorimit të administratës apo dhe infrastrukturës publike në funksion të fushatës zgjedhore sipas ndarjes në qarqe, në kundërshtim me ligjin¹⁴.
- Grupet hetimore në terren do të kryejnë verifikime në varësi të denoncimeve për kryerjen e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve të marra nga Struktura Qendrore, nga shoqëria civile, publiku, media ose nga referimet e marra nga policia e shtetit, si dhe subjektet private dhe shtetërore.
- Gjatë periudhës zgjedhore grupet hetimore në terren koordinojnë dhe bashkëpunojnë edhe me drejtuesit dhe prokurorin e gatshëm të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, drejtuesit e drejtorive të policisë, drejtues të agjencive ligjzbatuese dhe institucioneve të tjera publike në nivel qendror dhe lokal si dhe vëzhguesit e zgjedhjeve, median, shoqërinë civile, në qarkun që ata mbulojnë.

¹⁴ Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91 dhe neni 92.

Komunikimi me Publikun

Do të ngrihet një platformë e dedikuar për denoncime për kryerjen e veprave penale në kuadër të zgjedhjeve në faqen zyrtare online të Prokurorisë së Posaçme ku do të konsiderohet përfshirja e një:

- **Numri telefoni emergjent:** Krijimi i një numri të posaçëm për qytetarët, vëzhguesit e zgjedhjeve dhe institucionet që duan të raportojnë shkeljet ligjore përgjatë periudhës zgjedhore.
- **Platforme online:** Një faqe interneti për raportime anonime, duke përfshirë ngarkimin e provave si video, foto dhe dokumente.
- **Poste elektronike:** Një adresë e-mail e dedikuar për raportime me fakte shoqëruese.

Në lidhje me marrëdhëniet me publikun do të ngrihet një grup pune, i cili do të monitorojë të dhënat e bëra publike në media dhe rrjetet sociale mbi dyshimet e kryerjes së veprave penale të mundshme në kuadër të zgjedhjeve. Sipas rëndësisë, do të kryhen komunikime me publikun në formë njoftimesh dhe deklaratash për shtyp.

Regjistrimi i të dhënave

- Sektori i Protokoll/Arkivës merr masa për të hapur një libër protokollit të veçantë për regjistrimin e korrespondencave që kanë të bëjë me veprave penale në kuadër të zgjedhjeve, me qëllim nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave në mënyrë sa më të shpejtë dhe të saktë.

Mbështetja financiare dhe infrastrukturore

- Strukturat përkatëse marrin masa për lëvrimin në kohë të fondeve për shpenzimet që do të kryhen si dhe sigurojnë kapacitetet teknike të nevojshme përgjatë periudhës zgjedhore.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit dhe efektivitetit të kësaj Strategjie do të kryhet nga Struktura Qendrore. Ky vlerësim do të marrë në konsideratë: nivelin e zbatimit të masave, takimet me institucionet publike me të cilët është bashkëpunuar gjatë zbatimit të kësaj Strategjie, raportimet e gazetarëve/mediave si dhe të organizatave të shoqërisë civile/organizmave ndërkombëtarë, të angazhuar në monitorimin e këtyre zgjedhjeve. Konkluzionet/gjetjet e nxjerra nga vlerësimi i zbatimit të kësaj Strategjie do të përdoren për të identifikuar mundësitë për përmirësimin e procedurave/mjeteve të parandalimit dhe hetimit të veprave penale në kuadër të zgjedhjeve. Monitorimi dhe vlerësimi do të garantojnë që Strategjia të përshatet sipas nevojave dhe sfidave që mund të lindin gjatë hetimeve të këtyre veprave penale.

Bashkëpunimi vendas dhe ndërkombëtar

- Prokuroria e Përgjithshme
- Prokuroritë e juridiksionit te përgjithshëm sipas qarqeve (12 qarqe)
- Komisioni Qendror Zgjedhor
- Policia e Shtetit
- Agjencia e Inteligjencës Financiare
- Shërbimi Informativ i Shtetit
- Misionet e asistencës ndërkombëtare pranë Prokurorisë së Posaçme
- Organizatat Ndërkombëtare
- Shoqëria civile
- Gazetarët/Media
- Subjekte private
- Etj.